



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS**

INSTITUCIONE DHE ORGANIZMA KOMBËTARE DHE NDËRKOMBËTARE

Ngarkesa: 3 ECTS | 10 orë leksion | 20 orë seminar

Viti akademik / semestri kur zhvillohet: Viti II, Semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Program studimi profesional dyvjeçar në “Komunikim shumëgjuhësh në Institucione dhe Ndërmarrje”

Kodi i etikës: Kodin e Etikës së UT-së, (Nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE E LËNDËS:

Objektivat e përgjithshme lëndorë: T’u japë studentëve një kuptim të gjerë dhe praktik mbi funksionimin e institucioneve kombëtare dhe ndërkombëtare në kontekstin politik, ekonomik dhe shoqëror. Të zhvillojë aftësinë e studentëve për të analizuar ndërveprimet mes institucioneve kombëtare dhe organizatave ndërkombëtare në kuadrin e bashkëpunimit dhe integritetit evropian. Të nxisë ndërgjegjësimin qytetar dhe kulturën institucionale përmes studimit të rolit që luajnë këto institucione në qeverisjen demokratike, sigurinë dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

Objektivat specifike lëndorë:

1. Të identifikojë dhe përshkruajë institucionet kryesore kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe funksionet e tyre në fushën e politikës së jashtme, sigurisë, arsimit dhe ekonomisë.
2. Të shpjegojë marrëdhëniet ndërmjet institucioneve shqiptare dhe organizatave ndërkombëtare përmes analizës së shembujve konkretë dhe dokumenteve zyrtare.
3. Të analizojë ndikimin e institucioneve kombëtare në procesin e integritetit evropian dhe në zhvillimin e politikave publike.
4. Të aftësojë studentët në interpretimin e dokumenteve shumëgjuhëshe dhe komunikimeve institucionale në kontekst ndërkombëtar.
5. Të aplikojë njohuritë teorike në analiza të rasteve praktike që lidhen me bashkëpunimin ndërkombëtar dhe menaxhimin e konflikteve.

Rezultate të pritshme lëndorë:

Pas përfundimit të lëndës, studenti do të jetë në gjendje të:

- Përshkruajë shkurtimisht funksionimin e organizatave dhe institucioneve në kuadrin e brendshëm dhe të jashtëm;
- Kuptojë ndikimin e tyre në jetën e përditshme dhe në marrëdhëniet mes shteteve;
- Analizojë dokumente zyrtare dhe komunikime institucionale, përfshirë ato shumëgjuhëshe;
- Japë shembuj praktikë të qeverisjes së mirë, bashkëpunimit ndërkombëtar dhe zgjidhjes së konflikteve;
- Tregojë si merr pjesë Shqipëria në këto organizata dhe çfarë përfitimesh ka;